



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 039

Prishtinë, më 10 tetor 2008, në orën 16:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 10 TETOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 69 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, për shqyrtim dhe miratim të ligjeve sipas procedurës së veçantë, të datës 15 shkurt 2008, Komisioni ad-hoc e ka shqyrtuar Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime, i cili iu është shpërndarë deputetëve.

Ai e ftoi deputetin Ramadan Gashi, që në emër të Komisionit ad-hoc, ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

Ramadan Gashi tha se Komisionit Ad Hoc, pajtim me vendimin e Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008 dhe të seancës së mëparshme, e ka shqyrtuar Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe ka konstatuar se i plotëson të gjitha kriteret. Komisioni i rekomandon Kuvendit që të njëjtin ta miratojë në formën e propozuar nga Qeveria e Kosovës.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me Raportin e Komisionit Ad Hoc.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja** tha se Projektligji i plotëson kriteret e mundshme për rrethanat në të cilat gjendemi dhe e mbështesim.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri** tha se me këtë Projektligj është arritur që së paku atë kategori të pjesëtarëve të TMK-së, të cilët nuk do të mund të përfshihen në Forcën e Sigurisë së Kosovës, ta vendosim nën përkujdesje shtetërore.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli deklaroi se e përkrahin miratimin e këtij projektligji.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, tha se mbështesin miratimin e këtij projektligji në leximin e dytë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli tha se mbështet Raportin e Komisionit Ad Hoc dhe do të votojë pro këtij projektligji.

Kryetari hodhi në votimi miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari Konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 16:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale